



A.nr.607/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.607/2026, të datës 08.06.2026, të parashtruar nga ankuesi E.B nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.06.2026, nxjerrë, këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.607/2026, e datës 08.06.2026, e parashtruar nga ankuesi E.B.

A r s y e t i m

Ankuesi E.B (*tutje referuar ankuesi*), më datë 08.06.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit/Njoftimit të datës 05.06.2026, për refuzimin e aplikacionit, lidhur me konkursin për pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative* të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të çështjes ka konstatuar se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka shpallur konkursin e jashtëm me Nr.01/2026, për pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative*.

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës del se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo, sipas Vendimit/Njoftimit të datës 05.06.2026, të njëjtit i është refuzuar aplikacioni, me arsyetimin se nuk posedon përvojë të punës pas diplomimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton vendimin/njoftimin për refuzimin e aplikacionit, me pretendimin se ka dorëzuar dokumentet që dëshmojnë përvojën e punës profesionale dhe askund në konkurs nuk përcaktohet se kjo përvojë duhet të jetë pas diplomimit, ngase përvoja ime është edhe relevante edhe profesionale. Kërkon që të aprovohet ankesa të anulohet vendimi i kontestuar dhe të bëhet rivlerësimi i aplikacionit.

Në kuptim të praneushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht, nenit 39, paragrafi 12 i cili përcakton se: *“12. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”*, si dhe nenit 28 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimi, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, parashihet se: *“Kandidati i pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare ka të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankuesit e parashtruar më datë 08.06.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër njoftimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankueses të datës 08.06.2026, nuk kishte përfunduar procedura e pranimi sipas konkursit me Nr. 01/2026, për pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative* të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, rrjedhë se ankesa e ankuesit A.nr.607/2026, e datës 08.06.2026 është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 28 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimi, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.607/2026 nuk mohon të drejtën e ankuesit që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda;A.nr.607/2026, datë 22/06/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit E.B
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.